



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 130 Datë 13.09.2012

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LIÇENSËS ME
SERI PV03K, TE SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE NGA HEC
“BARMASH”, TE MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE-S, NR. 20, DATE 19.12.2003, MODIFIKUAR
ME VENDIMIN NR. 79 DATE 23.10.2009**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës me seri PV03K, te shoqërisë “BALKAN GREEN ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “BARMASH”, te miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 20, date 19.12.2003, modifikuar me vendimin nr. 79 date 23.10.2009.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.